



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KËSHILLI I GJYKATËS

VENDIM
Nr. 2, datë 09.04.2020

**PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË TRUPAVE GJYKUESE TË
KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të nenit 27 pika 1, nenit 28 pika 6 dhe 7, nenit 31, si edhe të nenit 38 shkronja “ç” të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi materialin me shkrim që përmban të dhënat mbi numrin, llojin, natyrën dhe kohën e paraqitjes së çështjeve gjyqësore dhe numrin e gjyqtarëve e të këshilltarëve ligjorë në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, si edhe pasi vlerësoi mendimin e dhënë nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Gjykatës

VENDOSI:

1. Caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit Kolegj të Gjykatës së Lartë, si më poshtë:

- a) Trupa gjykuese e Kolegjit Civil të jetë me këtë përbërje: z. Ardian Dvorani, z. Ervin Pupe, z. Sokol Sadushi (gjyqtar plotësues);
- b) Trupa gjykuese e Kolegjit Penal të jetë me këtë përbërje: z. Ilir Panda, z. Ardian Dvorani (gjyqtar plotësues), z. Ervin Pupe (gjyqtar plotësues);
- c) Trupa gjykuese e Kolegjit Administrativ të jetë me këtë përbërje: z. Sokol Sadushi, z. Ardian Dvorani (gjyqtar plotësues), z. Ilir Panda (gjyqtar plotësues).

2. Në rast të mungesave objektive dhe pengesave ligjore, përbërja e Kolegjit përkatës plotësohet nga gjyqtari i katërt që nuk është caktuar në përbërjen e përhershme të trupës gjykuese përkatëse sipas pikës 1 më sipër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

ANËTAR

Agim Gogu
Kancelar i Gjykatës së Lartë

ANËTAR

Ardian Dvorani
Zëvendëskryetar i Gjykatës së Lartë